



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

---

Numri i lëndës: 2022:141604

Datë: 01.11.2022

Numri i dokumentit: 03593577

P.nr.250/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me procesmbajtësen – Bahrije Smakolli, në çështjen penale kundër të pandehurit J.S. për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me nenin par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1366/22 e datës 06.07.2022, më datë 01.11.2022 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorit të shtetit PP-II.nr.1366/22 e datës 06.07.2022, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I PANDEHURI J. S. nga i ati S. dhe e ëma L., i lindur më ..., në V. rr. “B. Z.” ku edhe tani jeton, me numër personal ... ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, punëtor fizik, i gjendjes së mesme ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 15.04.2022 rreth orës 15:45, në V. në rr.” F. H.”, te fusha artificiale sportive, pa autorizim ka poseduar substancë narkotike, në atë mënyrë që me rastin e kontrollimit nga ana e policisë, në kuadër të operacionit STOP DROGAVE NËPËR SHKOLLA, është zënë se me vete ka substancë të dyshimtë narkotike në të cilën është vërtetuar prania e kanabisit (marihuanës) e cila përmban tetrahidrokanabinol (THC), ME PESHË  $0.56 \pm 0,0001$  gram, e cila i është marrë me këtë rast,

- Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me nenin par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69, 70, 269 të KPRK-së, si dhe nenit 450, dhe 495 të KPPK-së, e

### G J Y K O N

TË PANDEHURIT J.S. i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej katërqind (400) euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

URDHËROHET – konfiskim i përhershëm i substancës narkotike e llojit marihuana (kanabis) e cila përmban tetrahidrokanabinol (THC) në peshë  $0,56 \pm 0,0001$ .

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP-II.nr.1366/22 e datës 06.07.2022, kundër të pandehurit J. S. për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me nenin par.1 të KPRK-së.

Gjykatës i është kërkuar që kundër të akuzuarit të jep Urdhër Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë së shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale me të cilën akuzohet të pandehurit J.S. ligjvënësi ka paraparë dënim me gjobë ose dënim me burgim deri në një (1) vit, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 dhe 494 të KPPK-së, Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së ashtu që morri vendim që ta pranojë kërkesën për dhënie e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës: Raport fillestar i incidentit i datës 15.04.2022, raport i oficerit, i datës 15.04.2022, vërtetim mbi sekuestrumin e sendeve përkohësisht i datës 15.04.2022, procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin, i datës 15.04.2022, janë prova të besueshme të cilat vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë

elemente të veprës penale “Posedim i paautorizuar i narkotikëve”, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me nenin par.1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhër ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë gjykata mori parasysh rrethanat lehtësuese si: moshën e re të të pandehurit si dhe bashkëpunimin vullnetar të të pandehurit me policinë ashtu që i njëjti e kishte pranuar kryerjen e veprës penale qysh në dhënien e deklaratës në polici. Si rrethana rënduese, gjykata mori parasysh: shkallën e përgjegjësisë penale, meqë rast vepra është kryer me dashje nga ana e të pandehurit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale si dhe faktin se veprat penale të kësaj natyre janë në rritje e sipër, ndërsa rrethana të tjera rënduese, gjykata nuk gjeti.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështirim me nenin 38 të Kodit Penal të RKS-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, vepra këto të cilat janë në rritje e sipër, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsojë dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Urdhrin për konfiskimin e substancës narkotike, gjykata e ka marrë konform nenit 269 par.3 të KPRK-së, ku është përcaktuar se “*Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen*”.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par.2 nën par.2.6 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.250/22, datë 01.11.2022

Procesmbajtësja  
Bahrije Smakolli

GJYQTARI  
Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.